MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Prefekturën e Qarkut Tiranë me objekt: "Mbi veprimtarinë ekonomike e financiare dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së auditimit të brendshëm" për periudhën 01/01/2010-31/12/2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH nr. 49, datë 11.4.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01/06/2000, me shkresën nr. 141/5, datë 11/4/2012 dërguar **z. Kletis KRUJA,** Prefekt i Qarkut, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa, që të hartohet lista e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra të konstatuara gjatë procesit të inventarizimit, për daljet jashtë përdorimit. Gjithashtu, të kryhet procesi i vlerësimit dhe i nxjerrjes jashtë përdorimit, në bazë të kritereve dhe kërkesave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Brenda datës 31.07.2012

2. Të merren masa nga Sektori i Financës, që të bëhet evidentimi i saktë dhe kontabilizimi i të gjithë detyrimeve debitore nga të tretët, si për rastet e ofrimit të shërbimit të aktekspertizave, ashtu edhe për vendimet e gjobave të prera, për rastet e kundërvajtjeve administrative.

Vazhdimisht

3. Të merren masa për ndjekjen e arkëtimeve të detyrimeve të të tretëve dhe të gjobave nga Prefektura, duke bërë herë pas here njoftime subjekteve debitore si dhe Zyrës së Përmbarimit, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

Vazhdimisht

4. Të merren masa, që në të ardhmen të mos plotësohen dy formatet, nr. 10 e nr. 11 të Pasqyrave Financiare Vjetore (Bilancit), respektivisht "Pasqyra e konsoliduar e gjendjes financiare" dhe "Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave e shpenzimeve të funksionimit", pasi ky institucion nuk ka njësi vartëse me bilanc më vete, mbështetur në cilësimet e këtyre formateve si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen e raportimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre", i ndryshuar.

Vazhdimisht

5. Për një pasqyrim të saktë e real të llogarive të Pasqyrave Financiare Vjetore (Bilancit), të punohet në vazhdimësi, që në llogarinë 436 "Sigurimet shëndetësore", të evidentohet vetëm vlera e përllogaritur për sigurimet shëndetësore, përkatësisht 3.4 %, të cilësuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, kapitulli 4 "Nxjerrja e llogarisë vjetore (bilanci kontabël)".

Vazhdimisht

6. Të merren masa, që të sistemohen këto pozicione debitore e kreditore:

i) pozicioni kreditor i punonjëses [redacted], i evidentuar në llogarinë 423-429 "Personeli, paradhënie e gjoba", në vlerën prej 8,029 lekë, të mbajtura gabimisht më tepër në muajin Gusht 2010, duke ja kthyer vlerën punonjëses aktuale, e si rezultat kryhet mbyllja e këtij pozicioni;

ii) dy pozicionet kreditore, të dy personave fizik, në llogarinë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në vlerën totale prej 2,900 lekë, të krijuara gjatë viteve 2006 e 2007,

duke i derdhur në buxhetin e shtetit, nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, meqenëse ka kaluar një periudhë gati 3 vjeçare, e si rezultat kryhen edhe mbylljet e këtyre pozicioneve;

iii) dy pozicionet kreditore të llogarisë 466 "Kreditor për mjete në ruajtje", në vlerën prej 117,790 lekë, për sa derdhur gabim nga Komuna Ballsh, në një rast në vlerën 100,000 lekë për shërbime të ndryshme nga zjarrfikëset në vitin 2009 si dhe derdhur pa ndonjë destinacion nga firma private "[redacted]", vlera prej 17,790 lekë në vitin 2008, duke i derdhur në buxhetin e shtetit, nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, meqenëse ka kaluar një periudhë gati 3 vjeçare, e si rezultat kryhen edhe mbylljet e këtyre pozicioneve si dhe e llogarisë aktive të bilancit 520 "Disponibilitete në thesar".

Menjëherë

7. Të merren masa, që Sektori i Auditimit të Brendshëm të miratojë manualin e tij specifik, sa më parë, duke negociuar edhe me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, konformë urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 69, datë 29.09.2010 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik", në mënyrë që gjatë vitit 2012 e në vazhdim të kryejë auditimet përkatëse, vetëm me këtë manual.

Menjëherë

8. Të merren masa, që në fillimin e vitit 2012 të programohen për auditim 5 subjekte, me tejkalim të afatit 2 vjeçar pa u audituar, si Komunat Krrabë, Pezë, Prezë, Paskuqan dhe Këshilli i Qarkut Tiranë.

Menjëherë

9. Të merren masa nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm, në ato komuna me aktivitet ekonomik financiar në rritje të buxhetit mbi 50 milion lekë në vit, konformë VKM nr. 345, datë 01.06.2004.

Vazhdimisht

10. Për të rritur zbulimet në auditimin e prokurimeve publike, në auditimin e zbatimit të kontratave të investimeve, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut të gjenden mundësitë, për aktivizimin e specialitetit "inxhinier ndërtimi" në grupet e auditimit.

Vazhdimisht

11. Të merren masa, që të gjitha automjetet e sektorit të PMNZSH-së si dhe 3 automjetet, në dispozicion të Administratës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, sipas pasqyrave nr. 1 e nr. 2 bashkëlidhur, të kryejnë kontrollin teknik të detyrueshëm, me qëllim, që të kontrollohen, nëse ato garantojnë sigurinë dhe qetësinë në qarkullim dhe, që ndotja e tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar, në mbështetje të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjithashtu për automjetin me targë TR 7523 I të administratës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, të lidhet kontratë sigurimi, konform ligjit nr. 10070, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Vazhdimisht

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Ymer Stafa, Irma Shkupi dhe Erion Petanaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj dhe Drejtori Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT